



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGË VENDORE TIRANË

NOTER ARIAN A. MERKURI
ADRESA IBRAHIM RUGOVA,
SHALLVARET
TEL: 692083646

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 914

Nr. koleksioni: 424.

Tirane më 17/05/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2021050600050220734



A2021050600050220734

KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

(TË SHOQËRISË "RADIO ON" SH.P.K)

Sot, më datë 14.05.2021, para meje Noter ARIAN A. MERKURI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, IBRAHIM RUGOVA, SHALLVARET, u paraqit personalisht:

SHITES: Enver Mehmeti, atësia Skënder, amësia Aishe, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, me adresë Rr.Dalip Peza-Lagia 17; Nd. 0; Durrës; Durrës; 2006; Durrës, lindur më 22/08/1962, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035957983 dhe nr. personal G20822071P, ne cilesine e Ortakut me 1 kuote me pjesmarrje 40% dhe Administrator i Shoqërisa " RADIO ON " shpk person juridik rregjistruar ne QKR i pajisur me NIPT: 1144240233 me adresë Rr. Ibrahim Rugova 61/1/3, Tirane.

SHITES: Gentian Ferhati, atësia Bashkim, amësia Myrvete, shtetas Shqiptar, lindur në Shkodër dhe banues në Tiranë, me adresë R.Petrela; Nd. 061; H. 00; Ap. 00; Njësia Administrative Nr. 9; Tiranë; 0000; Tiranë, lindur më 04/06/1978, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035971327 dhe nr. personal H80604079N, ne cilesine e Ortakut me 1 kuote me pjesmarrje 60% te kuotave te Shoqërisa " RADIO ON " shpk.

BLERES: Luan Banushi, atësia Nusret, amësia Sabihe, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në Tiranë, me adresë Koferenca Pezes; Nd. 1; H. 1; Ap. 1; Njësia Administrative Nr. 7; Tiranë; 0000; Tiranë, lindur më 29/05/1984, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035873534 dhe nr. personal 140529119M, .

BLERES: Eri Moçi, atësia Mirjan, amësia Mimoza, shtetas Shqiptar, lindur në Kavajë dhe banues në DËRRËS, me adresë Epikadeve 00690227; Nd. 22; H. 3; Ap. 12; Durrës; Durrës; 2025; Durrës, lindur më 27/02/1991, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034904732 dhe nr. personal J10227058U, .

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noteri konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noteri redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "RADIO ON" Sh.p.k, sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

Neni 2

Objekti i kontratës

Objekti i kontratës është shitja nga shitesit kundrejt blerësit, të **100 % (njqind për qind)** të pjesëve/kuotave ose **2 (dy) kuotave/pjesëve** të kapitalit, me një vlerë të përgjithshme prej **15.000** Euro (pesëmbdhjetemije), që shitësit zotërojnë në shoqërinë "RADIO ON" shpk.

Neni 3

Çmimi i shitjes.

Çmimi total i shitjes së kuotave që do t'i paguhet Shitësit nga prej **15.000** Euro (pesëmbdhjetemije), do të paguhet në llogarinë bankare në euro të Noterit Arian A.Merkuri pranë Union Bank sh.a, i cili pas regjistrimit në QKB të kësaj kontrate të shitjes së kuotave në emër të blerësit, do të beje kalimin e shumës në llogarinë bankare, të Shitesve, z.Enver Mehmeti.



A2021050600050220734

Neni 4

Palet kane rene dakort qe bleresit Luan Banushi dhe Eri Moçi te marin persiper kryerjen e pagesave te cmimit te Shoqerise RADIO ON shpk deri me date 25.05.2021,

Neni 5

Menyra e kalimit te pronesis se kuotave.

Palet kane rene dakort qe me nenshkrimin e kesaj kontrate, shitesit te humbin pronesine e 100.00% (njeqindperqind) te kuotave ne kapitalin e shoqerise se mesiperme, duke mos patur ne te ardhmen asnje pretendim pronesis.

Bleresi me nenshkrimin e kesaj kontrate behet pronar i 100.00% (njeqindperqind) te kuotave ne shoqerine "RADIO ON" shpk dhe merr persiper te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe lindin nga zoterimi i ketyre kuotave, prej dates se lidhjes se kesaj kontrate e ne vazhdim.

Keshtu, me perfundimin e ketij transaksioni shitje, do te kemi kete zoterim te kuotave ne shoqerine "RADIO ON" shpk :

Bleresi, Eri Moçi, do te zoteroje 1(nje) kuote me pjesmarrje ne perqindje 50% (pesedhjetepaqind) **Bleresi, Luan Banushi**, do te zoteroje 1(nje) kuote me pjesmarrje ne perqindje 50% (pesedhjetepaqind) kuotave te shoqerise "RADIO ON" shpk

Administratori i shoqerise "RADIO ON" shpk do te jete z.Luan Banushaj per nje periudhe 5 vjecare

2.Shitesit, Gentian Ferhati dhe Enver Mehmeti pas ketij trasaksioni nuk do te zoteroje asnje kuote ne shoqerine "RADIO ON" shpk.

Neni 6

Detyrimet e shitësit

Shitësit do të pranojë çmimin e shitjes, të parashikuar në Nenin 3, si çmimin e plotë dhe përfundimtar të shitjes së kuotave, që ai kishte në shoqërinë "RADIO ON" Shpk, kuota të cilat tashmë i kalojnë Blerësit.

Shitësit garantojnë se kuotat, të cilat shiten me këtë kontratë, nuk janë të lëna peng, në dorëzani apo të rënduara me ndonjë lloj tjetër barre dhe se ata janë të vetmit pronarë të tyre e gëzojnë të drejtat e plota mbi to, fakt të cilin e verteton me shkresën e Regjistrimit të Barrave të Sigurisë Tirane dhe për çdo pretendim që mund të ngrejnë të tretet për çmimin e të drejtës së pronesisë së pales blerese (eviksion), ne jam i gatshëm dhe i detyruar të paraqitem menjehere me kërkesën e pales blerese dhe të çdo personi tjetër të tretet, që pretendon mbi keto kuota, para gjithë organeve gjyësore dhe administrative për të mbrojtur të drejtën e tij, si pronar i ligjshëm i ketyre kuotave pas nenshkrimit të kesaj kontrate.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësit heqin dorë nga të drejtat që ai kishte mbi kuotat objekt i kësaj kontrate, të drejta që i kalojnë blerësit.

Shitësit do të marrin të gjitha masat për të garantuar përmbushjen e të gjitha detyrimeve të marra prej tyre në bazë dhe për zbatim të kësaj kontrate.

Neni 7

Detyrimet e Blerësit

Blerësi do të paguaj çmimin e blerjes, sipas mënyrës së parashikuar në nenin 4 të kësaj kontrate.

Pala blerëse ka marre ne dorzim kuotat dhe do te likudoje palen shitesse kundrejt cmimit te percaktuar ne nenin 3 te kesaj kontrate, duke mos patur asnje verejtje sipas dokumentit ligjor.

Neni 8

Detyrimet e perbashketa te paleve

Palët ne këtë kontrate kane rene dakort dhe do të marrin të gjitha masat për të regjistruar transferimin e kuotave objekt i kësaj kontrate , në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 9

Efektet e kontrates

Kalimi i pronesisë së kuotave nga pala shitesse tek pala blerese palet deklarojne se jane dakort te realizohet menjehere pas kryerjes se te gjitha detyrimeve ne perputhje me percaktimet e kesaj kontrate nga bleresi dhe perfundon me regjistrimin e kesaj kontrata prane Qendres Kombetare te Regjistrimit dhe ne perputhje me percaktimet e ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" i ndryshuar.

Kalimi i kuotave sipas kesaj kontrate regjistrohet ne perputhje me dispozitat e ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" i ndryshuar, pas likuidimit te plote te detyrimeve nga pala blerese.



A2021050600050220734

Neni 10
Gjuha e Kontratës

Kjo kontratë përgatitet në 4 ekzemplarë, në gjuhën shqipe, të gjitha të njëjlershme dhe originale nga të cilat një qëndron në zyrën e notarisë, një kopje duhet të depozitohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (OKR), një kopje duhet të depozitohet në selinë e shoqërisë dhe nga një kopje e merr secila palë.

Secila prej palëve në këtë kontratë do të marrë një ekzemplar të kontratës.

Kjo kontratë pasi u lexua me zë të lartë Shitësit dhe Blerësi, deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj, ata më deklaruan që ajo është në përputhje të plotë me vullnetin e tyre të lirë, u nënshkrua prej tyre në praninë time dhe unë noteri e vërtetoj atë në bazë të ligjit.

SHITESIT

Gedion Ferri

Enver Murrizi

BLERESI

Arum Bamudni
Eri Mogi

NOTER

ARIAN A. MËRKURI

[Signature of Arian A. Mërkuri]





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
KRYETARI

Nr. 1773/prot.
19

Tiranë, më 30. 4 .2021

Lënda: Njoftim vendimi

SHOQËRISË “RADIO ON” SH.P.K.

Rruga “Ibrahim Rugova”, Ndërtesa nr. 28, Hyrja 8, Njësia nr. 5, Tiranë

SHOQËRISË “RTV ADRIA-MED” SH.P.K. ✓

Rruga “Shyqyri Bërxolli”, Ambient Shërbimi Nr. 28, Seksioni B, Akset D-H dhe 1-3, Kati +1, Njësia Bashkiake Nr. 10, Tiranë

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në mbledhjen e tij të radhës, me vendimin nr. 66, datë 27.04.2021, ka vendosur:

1. Kalimin e të drejtave të licencës së shoqërisë “RTV ADRIA-MED” sh.p.k., për subjektin audio privat “Radio Durrësi”, tek shoqëria “RADIO ON” sh.p.k., me NIPT: M11424023B, administrator z. Enver Mehmeti, ortakë Gentian Ferhati me 60% të kuotave dhe Enver Mehmeti me 40% të kuotave.
2. Licenca e shoqërisë “RTV ADRIA-MED” sh.p.k., për subjektin audio privat “Radio Durrësi”, bëhet e pavlefshme.

Bashkëlidhur vendimi i AMA-s nr. 66, datë 27.04.2021.

KRYETARI
Gentian Sala



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Nr. 713 prot.,

Tiranë, më 27.4.2021

VENDIM

NR. 66, DATË 27.04.2021

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARAQITUR NGA SHOQËRIA "RTV- ADRIA MED" SH.P.K., PËR KALIMIN E TË DREJTAVE TË LICENCËS SË SHOQËRISË "RTV-ADRIA MED" SH.P.K., PËR SUBJEKTIN AUDIO "RADIO DURRËSI", TEK SHOQËRIA "RADIO ON" SH.P.K.

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen që i përket palëve:

Kërkues: Shoqëria "RTV-ADRIA MED" sh.p.k.,

Objekt: Shqyrtimi i kërkesës së paraqitur nga shoqëria "RTV- ADRIA MED" sh.p.k., për kalimin e të drejtave të licencës së shoqërisë "RTV-ADRIA MED" sh.p.k., për subjektin audio "Radio Durrësi", tek shoqëria "Radio ON" sh.p.k.

Baza Ligjore: Nenet 19, pika 16 dhe 55, pika 6 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

VËREN

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (sot Autoriteti i Mediave Audiovizive), AMA, me vendimin nr. 202, datë 20.12.2010, ka licencuar shoqërinë "Radio Durrësi" sh.p.k., për ofrimin e shërbimit audio për subjektin "Radio Durrësi". Me vendimin nr. 252, datë 21.12.2016, AMA ka vendosur kalimin e të drejtave të licencës tek shoqëria "RTV Adria-Med" sh.p.k., ndërsa me vendimin nr. 98, datë 11.07.2019, ka vendosur rinovimin e licencës së subjektit. Me vendimin nr. 170, datë 18.11.2019, AMA, ka miratuar ndryshime në strukturën e pronësisë së subjektit si dhe ndryshimin e emrit të subjektit audioviziv nga "Tv Adriamed" në "Premium Channel". Afati i vlefshmërisë së licencës përfundon në datën 30.12.2023.



Nga ana tjetër, shoqëria "RTV- ADRIA MED" sh.p.k., është e pajisur me licencë shërbim programi audioviziv "Premium Channel", për të ofruar shërbim në Qarqet Tiranë, Durrës dhe Fier. Afati i vlefshmërisë së licencës së shërbimit është deri në datën 01.10.2027.

Struktura e pronësisë së shoqërisë "RTV-ADRIA-MED" sh.p.k., është: z. Enver Mehmeti, ortak me 40% të kuotave dhe z. Gentian Ferhati, ortak me 60% të kuotave.

Shoqëria "RTV-ADRIA MED" sh.p.k., me shkresën nr. 1041 prot., datë 02.03.2021, të depozituar pranë AMA-s, ka njoftuar krijimin e një subjekti të ri tregtar, shoqëria "Radio ON" sh.p.k., dhe ka kërkuar kalimin e të drejtave të licencës së shoqërisë "RTV-ADRIA MED" sh.p.k., për subjektin audio "Radio Durrësi", tek shoqëria "Radio ON" sh.p.k.

Duke qenë se shoqëria "Radio ON" sh.p.k., është subjekt tregtar me personalitet të ndryshëm juridik nga shoqëria "RTV-Adria Med" sh.p.k., licencuar për subjektin audio privat "Radio Durrësi", AMA me shkresat nr. 1480 prot., datë 13.04.2021 dhe nr. 1041/1 prot., datë 11.03.2021, ka kërkuar nga subjekti depozitim të dokumentacionit të mëposhtëm:

1. Ekstraktin Historik për të dhënat e shoqërisë "Radio ON" sh.p.k., origjinal ose kopje e njëzuar me origjinalin;
2. Të dhënat mbi kapitalin financiar të shoqërisë, në masën 2,500,000 lekë, në një nga format e mëposhtme, i pasqyruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ose i vërtetuar nga eksperti kontabël i miratuar/autorizuar;
3. Raport të detajuar mbi aspektet e funksionimit ekonomik të shoqërisë "Radio ON" sh.p.k., përfshirë këtu parashikimet për shpenzimet dhe të ardhurat për çdo vit, deri në përfundim të afatit të vlefshmërisë së licencës së subjektit, data 30.12.2023;
4. Dokumente zyrtare mbi vetitë dhe ekspertizën e organeve drejtuese të shoqërisë;
5. Strukturën programore (orët e transmetimit në ditë, programin javor të transmetimit, raporti i kohës së transmetimit që do të zënë emisionet e prodhuara vetë në lidhje me gjithë kohën e transmetimit, të dhënat statistikore për llojet e programeve që do të transmetohen, përmbajtja e programeve kryesore që do të transmetohen) dhe tematikën e programacionit, nëse do të pësojë ndryshime;
6. Të dhënat mbi numrin e punonjësve që subjekti parashikon të punësojë;
7. Listën emërore të anëtarëve të Bordit Drejtues dhe *Curriculum Vitae* të tyre.

Po ashtu subjektit i është kërkuar të depozitojë Certifikatën e Regjistrimit të Logos apo Markës, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI), lidhur me përdorimin e emrit "Radio ON", në rast të ndryshimit të emrit të subjektit audio nga "Radio Durrësi" në "Radio ON".

Në vijim të kërkesave të AMA-s, subjekti ka depozituar me shkresat nr. 1480 prot., datë 29.03.2021, nr. 1480/1 prot., datë 12.04.2021 dhe nr. 1480/3 prot., datë 14.04.2021, dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Emërtimin, vendndodhjen dhe përfaqësuesin ligjor të shoqërisë "Radio ON" sh.p.k., z. Enver Mehmeti;
2. Ekstraktin e Regjistrimit Tregtar për të dhënat e shoqërisë "Radio ON" sh.p.k., të datës 25.03.2021, nga i cili rezulton se: NIPT: M11424023B; Subjekti është regjistruar si i tillë në datën: 24.02.2021; Zyra qendrore e shoqërisë: Rruga "Ibrahim Rugova", Ndërtesa nr. 28, Hyrja 8, Njësia nr. 5, Tiranë; Objekti i veprimtarisë: "Të ushtrorë aktivitetin në

- fushën e veprimtarisë së transmetimit për radio, përfshi prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve me anë të zërit, sinjaleve të koduara për publikun nëpërmjet valëve elektromagnetike.....*”; Administrator i shoqërisë: Enver Mehmeti; Ortakë të shoqërisë: Gentian Ferhati me 60% të kuotave dhe Enver Mehmeti me 40% të kuotave; Emri tregtar: Radio ON; Statusi: Aktiv;
3. Saktësimin se do të vijojë të përdorë emrin “Radio Durrësi”;
 4. Të dhënat mbi programet të subjektit “Radio Durrësi”, ku kryesisht programacioni i saj është i dedikuar muzikës shqiptare dhe të huaj dhe materiali i folur zë, mbi 50% të kohës së transmetimit;
 5. Listën emërore të anëtareve të Bordit Drejtues dhe Curriculum Vitae të tyre si më poshtë: Enver Mehmeti; Gentian Ferhati; Fioralba Cena; Zamira Musaraj dhe Entela Hoxha;
 6. Kapitalin financiar sipas vlerës asetëve në masën 31,500 euro, të përgatitur nga Audituesi Ligjor Luan Gosnishti, datë 13 prill 2021. Sipas Bankës së Shqipërisë, kursi i këmbimit më datë 13 prill 2021 është 122.99 lekë/euro. Pra vlera e asetëve është 3,874,185 lekë;
 7. Parashikimin e planit ekonomik - financiar për periudhën 2021-2025, të ndarë në vite.

Po ashtu, subjekti, në datën 15.04.2021, ka kryer pagesën në masën 50.000 lekë, në zbatim të vendimit të AMA nr. 220, datë 01.12.2017 “Mbi përcaktimin e pagesave për licencë/autorizim dhe shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive”, për miratimin e ndryshimeve në të dhënat e licencës.

Nga verifikimi i kryer rezulton se ortakët e shoqërisë “Radio ON” sh.p.k., Enver Mehmeti, me 40% të kuotave dhe Gentian Ferhati, me 60% të kuotave, zotërojnë kuota edhe në subjekte të tjerë audiovizivë: Konkretisht, në shoqërinë “RTV-ADRIA-MED” sh.p.k., e pajisur me licencë shërbimi programi audioviziv “Premium Channel”, me strukturë pronësie: Enver Mehmeti, me 40% të kuotave dhe Gentian Ferhati, me 60% të kuotave si dhe në shoqërinë “Premium Media” sh.p.k., e pajisur me autorizim për ofrim shërbimi programi audioviziv online “Premium Travel”, me strukturë pronësie: Enver Mehmeti, me 70% të kuotave dhe Gentian Ferhati, me 30% të kuotave.

Bazuar në nenin 62 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar: “7. Një person fizik ose juridik që ka 100 për qind të aksioneve në një shoqëri që zotëron një licencë transmetimi audioviziv lokale apo rajonale, mund të marrë vetëm një licencë të dytë për transmetim audio lokale apo rajonale. Një person fizik ose juridik që ka 100 për qind të aksioneve në një shoqëri që zotëron një licencë transmetimi audio lokale apo rajonale, mund të marrë vetëm një licencë transmetimi audiovizive lokale apo rajonale.

Sa më sipër, gëzimi i kuotave nga ortakët e shoqërisë “Radio On” sh.p.k., z. Enver Mehmeti dhe z. Gentian Ferhati edhe në shoqërinë “RTV-ADRIA MED” sh.p.k., licencuar për subjektin audioviziv “Premium Channel”, nuk bie ndesh me parashikimet e nenit 62 të ligjit organik, pasi një person fizik që ka kuota në një subjekt të licencuar për shërbim audioviziv, sikurse është shoqëria “RTV-Adria-Med”, ka të drejtë të marrë një licencë të dytë për transmetim audio lokale apo rajonale, sikurse është shoqëria “Radio On” sh.p.k.

Ndërkohë, gëzimi i kuotave të ortakëve të shoqërisë “Radio On” sh.p.k., në shoqërinë “Premium Media” sh.p.k., duke qenë se kjo shoqëri është e pajisur me autorizim për ofrim shërbimesh mediatike dhe nuk shfrytëzon frekuenca radiotelevizive për ofrimin e shërbimit, nuk bie ndesh me kërkesat e nenit 62 të ligjit nr. 97/2013, të sipërcituar, që parashikon kufizimet e pronësisë në transmetimet audio dhe audiovizive tokësore.

Bazuar në nenin 55, pika 6 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar: "6. ... Në rast se mbajtësi i licencës dhe/ose autorizimit, hyn në marrëdhënie juridike civile, objekt i të cilave është edhe veprimtaria e licencuar/autorizuar, atëherë për cedimin ose kalimin e të drejtave që burojnë nga licenca dhe/ose autorizimi kërkohet miratimi i AMA-s. Subjektit që ka fituar këto të drejta, miratimi i jepet në formën e një licence dhe/ose autorizimi të ri me të njëjtën përmbajtje...."

Në rastin konkret, AMA konstaton se për shkak të krijimit të një subjekti të ri tregtar "Radio ON" sh.p.k., të drejtat e licencës së shoqërisë "RTV-ADRIA MED" sh.p.k., për subjektin audio privat "Radio Durrësi", do t'i transferohen shoqërisë "Radio ON" sh.p.k.

Për sa më sipër kërkesa e subjektit është e mbështetur në ligj,

PËR KËTO ARSYE,

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në mbështetje të nenit 19, pika 16 dhe nenit 55, pika 6 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Kalimin e të drejtave të licencës së shoqërisë "RTV-ADRIA MED" sh.p.k., për subjektin audio privat "Radio Durrësi", tek shoqëria "RADIO ON" sh.p.k., me NIPT: M11424023B, administrator z. Enver Mehmeti, ortakë Gentian Ferhati me 60% të kuotave dhe Enver Mehmeti me 40% të kuotave.
2. Licenca e shoqërisë "RTV-ADRIA MED" sh.p.k., për subjektin audio privat "Radio Durrësi", bëhet e pavlefshme.
3. Ngarkohet administrata e AMA-s për kryerjen e veprimeve të mëtejshme në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar: Gentian

Zëvendëskryetar: Sami

Anëtarë: Gledis

Suela

SALA

NEZAJ

GJIPALI

MUSTA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

**EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË
DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR”**

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	M11424023B
2. Data e Regjistrimit	24/02/2021
3. Emri i Subjektit	RADIO ON
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	23/02/2021
6. Kohëzgjatja	Nga: 23/02/2021
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Njesia Nr. 5, Rruga Ibrahim Rugova, Ndertesa Nr. 28, Hyrja 8
8. Kapitali	100.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,00
9. Objekti i aktivitetit	Te ushtroje aktivitetin ne fushen e veprimtaris se trasmetimit per radio, perfshi prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve te cdo lloji me ane te zerit, sinjaleve te koduara per publikun nepermjet valeve elektromagnetike, kablove perseritesve, sateliteve apo me cdo mjet tjeter. Per kryerjen e veprimtarise se saj shoqeria do te hape njesi sherbimi e tregetimi, duke bashkepunuar me persona fizik e juridik vendas dhe te huaj.
10. Administratori/ët	Enver Mehmeti
10.1 Afati i emërimit	Nga: 23/02/2021 Deri: 23/02/2026
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore	
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)	
12. Ortakët	GentianFerhati



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

12.1 Vlera e kapitalit	Para: 60.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	60,00	
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>		
12.4 Komete (nëse ka)		
13. Ortakët	EnverMehmeti	
13.1 Vlera e kapitalit	Para: 40.000,00	Natyre:
13.2 Numri i pjesëve	1,00	
13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	40,00	
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>		
13.4 Komete (nëse ka)		
14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: RADIO ON E-Mail: enver@vas.al Telefon: 0692021655	
16. Statusi:	Aktiv	

Lista e Dokumenteve:

Akti i themelimit

Statuti (nese eshte hartuar si dokument i ndryshem nga akti i themelimit)

Mandati bankar ose vertetimi i noterit per pagesen e kapitalit ne para - (nese kapitali eshte paguar)

Regjistrimi Fillestar: CN-663704-02-21

HISTORIKU I REGJISTRIMIT

Data e regjistrimit	Ndryshimi i te dhenave te regjistruara
---------------------	--

Datë: 07/05/2021

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT



Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date:2021/05/07 14:10:41 +02:00
M11424023B2021050714102367
3006